

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo		
Nr. i prot.	2022/ZDP/316	
Br. prot./Prot. Nr.		
Faqe:	Kopje: ARKIV	Datë: 11/10/2022
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date
Hyrës/ulazno/in	<input type="checkbox"/>	
Dalës/izlazo/out	<input checked="" type="checkbox"/>	
Brendshëm/nterno/internal	<input type="checkbox"/>	Prishtinë/Prishtina/Pristina

09/ZDP/VE/2022
Datë: 11 tetor 2022

Në mbështetje të nenit 15.1 (c), (e), (h), (j) dhe 21.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, dt. 4 qershor 2008), i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura, nenit 24 paragrafi 1 të Ligjit 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës,

Duke u bazuar në rekomandimin e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve, të dt. 31 gusht 2022,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Rregullorja (AAC) Nr. 04/2015 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore, e datës 05 tetor 2015.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës më datën 8 korrik 2015, ka nxjerrë Rregulloren (AAC) Nr. 04/2015 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore, e cila ka transpozuar në rendin ligjor të brendshëm Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 965/2012 për operimet ajrore të dt. 5 tetor 2012.

Në vitin 2019 Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka sponsoruar traspozimin e versionin e përditësuar të Rregullores së Komisionit (BE) nr. 965/2012 për operimet ajrore, e cila rregullore ishte ndryshuar me dymbëdhjetë (12) Rregullore te reja te BE-se për fushën e operimeve ajrore. Qëllimi i transpozimit të rregullores së re ishte përkatësisht edhe shfuqizimi i Rregullores (AAC) Nr. 04/2015 dhe zëvendësimi i saj me Rregulloren (AAC) Nr. 01/2019 me përditësimet e fundit.

Për shkak të një gabimi teknik Rregullorja (AAC) NR. 01/2019 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore në bazë të rregullores së AAC-së nr. 03/2009, nuk ka shfuqizuar Rregulloren (AAC) Nr. 04/2015. Për të tejkaluar këtë gabim teknik më datën 31 gusht 2022 Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka rekomanduar shfuqizimin e Rregullores (AAC) Nr. 04/2015 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me qëllim të korigjimit të gabimit teknik, në pajtim 15.1 (c), (e), (h), (j) dhe 21.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, me ndryshime si dhe nenin 41 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ngrit konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

